



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT**

Tiranë, më 11.06.2019

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE
TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA”**

- Hyrje

Të nderuar anëtarë/e të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Në bazë të Kalendarit të Punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, jam caktuar relator për projektligjin “*Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara*”, për të cilin Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut është komision përgjegjës.

Komisioni e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Projektligji ka për qëllim të përmirësojë procesin e miradministrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Çështja e administrimit të pasurive është diskutuar shumë në forumet ndërkombëtare dhe rajonale. Standardet përkatëse ndërkombëtare theksojnë se juridiksionet duhet të kenë mekanizma ligjorë për të menaxhuar në mënyrë efektive pasuritë e ngrira dhe të konfiskuara, në pritje të një vendimi të formës së prerë. (UNCAC, neni 60, Konventa e Varshavës, neni 6).

Për të administruar me sukses pasuritë ekziston një trend në rritje sipas të cilit juridiksionet duhet të krijojnë një zyrë qendrore kombëtare të administrimit të pasurive si nevojë për të administruar pasuritë "e vështira". Pa akte normative, mekanizma të përshtatshëm, struktura dhe bashkëveprim mes tyre, sekuestrimi dhe konfiskimi janë një proces i paplotësuar dhe joefektiv.

AAPSK-ja, në bazë të vendimit nr.687, datë 5.10.2011, të Këshillit të Ministrave, *“Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”*, të ndryshuar, kryesisht administron pasuritë e sekuestruara/të konfiskuara vetëm sipas ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, 1 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, të ndryshuar, ndërkohë që pasuritë e sekuestruara/ të konfiskuara në procesin penal i mbasin për administrim gjykatës, e cila i vetëmenaxhon ose ia cakton administrimin një burimi të jashtëm dhe në shume raste mbasin të paadministruara.

Për rrjedhojë, vjen si domosdoshmëri miratimi i këtij projektligji *“Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”*. Strukturat e zbatimit të ligjit dhe prokurorët shqiptarë, si dhe vlerësuesit e jashtëm kanë raportuar një nivel të lartë të konfuzionit të roleve dhe strukturave brenda procesit të konfiskimit të pasurisë në Shqipëri. Përqendrimi i administrimit të të gjitha pasurive do ta lehtësonte këtë nga pikëpamja e administrimit të pasurive. Ai gjithashtu lejon stafin brenda AAPSK-së të ndërtojë nivelin e ekspertizës për të qenë plotësisht efektiv.

III. RIFORMULIMET SIPAS NENEVE

Neni 1

1. Neni 1 “Objekti”, duhet të kalojë si Neni 3. Sipas teknikës legjislative, Neni 2 “Qëllimi” duhet të jetë Neni i parë. Për më tepër, projektligji i referohet “United Nations Convention against Corruption”; sic mund të vërehet edhe nga strukturimi në nene të Konventës së

Kombeve të Bashkuara, në Nenin e parë, fillohet gjithnjë me definimin e qëllimit (*Article 1. "Statement of purpose"*).

2. Ndryshohet struktura:

Neni 1 "Qëllimi"

Neni 2 "Përkufizime"

Neni 3 "Objekti"

Neni 4 "Fusha e Zbatimit" Neni 2

Neni 2

1. Neni 2 "Qëllimi", te kaloj si Neni 1.

2. U vendos që "kompensimi i viktimave të krimit" te ndryshojë në "kompensimi financiar i viktimave të krimit".

Neni 3

1. U vendos që Neni 3 të ndryshojë në Neni 4.

2. Neni 4, riformulohet si vijon:

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

- a) pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës kompetente, sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit;
- b) pasuritë e bllokuara e të sekuestruara, sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit;
- c) pasuritë, për të cilat është vendosur masa e sekuestrimit preventiv, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, dhe ato të konfiskuara me vendim të gjykatës kompetente, sipas dispozitave të Kodit Penal, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to.

Neni 4

1. Neni 4 i projektligjit "Përkufizime", spostohet dhe bëhet Neni 2 i projektligjit.

Neni 6

Pikat 4 dhe 5 të nenit 6 të projektligjit u vendos të bashkohen në një pikë të vetme (pika 4) e formuluar si vijon:

"4. Kriteret e përcaktimit të personelit të jashtëm si dhe kufijtë e pagave apo shpërblimit të tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat."

Neni 9

1. U vendos që pika 1 e nenit 9 të projektligjit te riformulohet si më poshtë:

“Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryeadministratori, i cili i raporton ministrit përgjegjës për financat. Marrëdhëniet e punës së kryeadministratorit rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.”

2. U vendos riformulimi i shkronjës “ç” të pikës 2, si më poshtë, me qëllim që kriteret dhe rregullat e hollësishme për hartimin e listës së administratorëve të miratohen me vendim të ministrit përgjegjës për financat:

ç) harton listën e administratorëve të pasurisë së sekuestruar, me persona të punësuar ose jo pranë Agjencisë, të cilën ia paraqet gjykatës, të paktën një herë në vit, brenda tremujorit të parë të vitit. Kriteret dhe rregullat e hollësishme për hartimin e listës së administratorëve miratohen me vendim të ministrit përgjegjës për financat.”

Neni 21

1. U vendos që pika 3 të riformulohet si më poshtë:

“Shitja e pasurisë së sekuestruar kryhet me ankand nga Agjencia sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për ankandin publik. Të ardhurat nga shitja e këtyre pasurive depozitohen në llogarinë e Agjencisë.”

Neni 35

1. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 35 të projektligjit u vendos që afati i parashikuar për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për financat, të jetë 3 muaj.

Neni 36

Neni 36 të riformulohet si më poshtë:

“Neni 36 Shfuqizime

1. Pika 2, e nenit 34, të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, shfuqizohet.
2. Vendimi nr.687, datë 5.10.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, rregullat e hollësishme për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, **si dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.”**

V. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

R E L A T O R

KRYETARI

ALKET HYSENI

ULSI MANJA